



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave

M a j 2 0 1 8

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave

(Bazuar në të dhënat e raportuara nga bankat komerciale në baza të rregullta periodike)

BOTUES ©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Sistemit të Pagesave
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE payment.systems@bqk-kos.org

SHKURTESAT:

ACH	Sistemi Automatik i Kliringut
ATM	Bankomat
ATS	Sistemi Automatik i Transferit
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DD	Debitim Direkt
DSP	Departamenti i Sistemit të Pagesave
EFT-POS	Transferimi Elektronik i Mjeteve në Pikat e Shitjes
POS	Pikë e Shitjes
RTGS	Shlyerjet Bruto në Kohë Reale
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SPN	Sistemi i Pagesave Ndërbankare

INFORMATË:

Për përshkrim më të detajuar referohuni shënimeve sqaruese.
Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës,
Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave, Prishtinë 2018.
Ky publikim përfshin të dhënat në dispozicion deri më 31 mars 2018.

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
1. NUMRI DHE VLERA E TRANSAKSIONEVE NDËRBANKARE	7
2. NUMRI I LLOGARIVE BANKARE	11
3. TERMINALET ATM DHE POS	14
4. NUMRI I KARTELAVE	15
5. TRANSAKSIONET ME KARTELA	18

PREZANTIMI GRAFIK

1. Përqindja e transaksioneve (numri) -----	9
2. Përqindja e transaksioneve (vlera) -----	9
3. Numri i transaksioneve ndërbankare -----	10
4. Vlera e transaksioneve ndërbankare -----	10
5. Numri i llogarive bankare -----	11
6. Numri i llogarive e-banking -----	11
7. Numri i transaksioneve e-banking -----	12
8. Vlera e transaksioneve e-banking -----	12
9. Shpërndarja e terminaleve ATM -----	13
10. Shpërndarja e terminaleve POS -----	14
11. Debit dhe kredit kartelat -----	15
12. Numri i përgjithshëm i kartelave -----	15
13. Poseduesit e kartelave sipas moshës -----	16
14. Poseduesit e kartelave sipas gjinisë -----	16
15. Pjesëmarrja e transaksioneve me kartela sipas numrit dhe sipas vlerës -----	18
16. Kartelat aktive -----	18

TABELAT STATISTIKORE

1. Numri i transaksioneve ndërbankare -----	7
2. Vlera e transaksioneve ndërbankare -----	8
3. Numri i llogarive bankare -----	10
4. Numri i llogarive e-banking sipas llojit -----	12
5. Numri dhe vlera e transaksioneve përmes Debitimit Direkt-----	13
6. Numri i terminaleve ATM -----	13
7. Numri i terminaleve POS-----	14
8. Numri i kartelave sipas funksionit -----	14
9. Numri i transaksioneve me kartela -----	17
10. Vlera e transaksioneve me kartela -----	17

Hyrje

Sistemet e pagesave të sigurta dhe efikase janë faktor i rëndësishëm për stabilitetin financiar dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Objektivi parësor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është nxitja dhe ruajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar si dhe një sistemi efikas të pagesave.

Në këtë kuadër, sigurimi i funksionimit normal të sistemeve të pagesave është një nga objektivat dhe detyrat kryesore të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Zhvillimet e shpejta teknologjike në fushën e sistemeve dhe instrumenteve të pagesave në nivel global kanë ndikuar, që edhe në Kosovë qytetarët të ndryshojnë mënyrat e pagesave duke u larguar nga shprehitë e të paguarit me para të gatshme, drejt mënyrave elektronike të pagesave përmes internetit dhe kartelave për pagesa. Edhe pse nuk ka një matje të saktë për raportin mes pagesave me para të gatshme dhe atyre përmes kanaleve elektronike, nga të dhënat statistikore që BQK-ja mbledh nga bankat komerciale në vend, vërehet një rritje e shpejtë e pagesave përmes mënyrave elektronike të pagesave.

Nga zhvillimet e fundit në instrumente dhe terminale të pagesave vlen të theksohet fillimi i përdorimit të kartelave dhe terminaleve për kryerjen e pagesave pa kontakt fizik (contactless) nga ana e disa bankave komerciale në vend. Kartelat dhe терминаlet e tilla do të zvogëlojnë kohën e kryerjes së transaksioneve në pika të shitjes, duke i bërë instrumente pagesash më të pranuar si për qytetarët ashtu edhe për tregtarët. Po ashtu, në kuadër të mënyrave elektronike të pagesave vërehet një trend i qëndrueshëm i rritjes së pagesave përmes shërbimit e-banking, si dhe pagesave përmes debit dhe kredit kartelave.

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës teknike dhe ligjore të raportimit të instrumenteve të pagesave, BQK-ja ka aprovuar Rregulloren e re për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave duke përafëruar bazën rregullative me atë të BE-së. Po ashtu, nga kjo periudhë ka filluar raportimi i statistikave përmes aplikacionit të ri që ka zhvilluar BQK-ja për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave i cili do të rritë efikasitetin në procesimin e statistikave nga fusha e sistemeve të pagesave.

1. Numri dhe vlera e transaksioneve ndërbankare

Numri dhe vlera e transaksioneve ndërbankare të analizuara në këtë tremujor, tregojnë për rritjen e vazhdueshme të numrit të transaksioneve ndërbankare përgjatë periudhave.

Numri i pagesave me vlerë të madhe (mbi 10,000 €) dhe atyre prioritare, të cilat procesohen përmes komponentit RTGS të Sistemit të Pagesave Ndërbankare, në tremujorin e parë të vitit 2018 (TM1 2018) kanë shënuar rritje prej 7.6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017 (TM1 2017). Numri i përgjithshëm i transaksioneve të procesuara përmes sistemit të RTGS-së gjatë TM1 të vitit 2018 arriti në rreth 24.74 mijë transaksione.

Në tabelën 1 është paraqitur numri i transaksioneve ndërbankare të procesuara përmes RTGS-së gjatë periudhave TM1 2017 deri më TM1 2018 të ndara sipas llojeve të pagesave. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë konstatohet se gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 pagesat e klientëve përbënin numrin më të madh të pagesave të procesuara përmes sistemit të RTGS-së me pjesëmarrje prej 93.3%, pagesat mes bankave 5.4% dhe Letrat me Vlerë 1.3%.

Tabela 1. Numri i transaksioneve ndërbankare në RTGS (në mijëra)

Lloji i pagesave	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Numri i pagesave RTGS	22.98	27.24	28.82	33.20	24.74
<i>Pagesa të klientëve</i>	21.24	25.41	26.87	31.36	23.11
<i>Pagesa bankë-bankë</i>	1.31	1.49	1.84	1.57	1.34
<i>Letra me Vlerë</i>	0.44	0.34	0.11	0.27	0.29

Burimi: BQK (2018)

Në tabelën 2 është paraqitur numri i pagesave të procesuara përmes sistemit të ACH-së nga tremujori i parë i vitit 2017 deri më tremujorin e parë të vitit 2018. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë vërehet se numri i përgjithshëm i pagesave të procesuara përmes sistemit ACH në TM1 2018 pati rënie prej 7.7% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Faktorët kryesorë që ndikuan në rënien e numrit të pagesave përmes sistemit ACH janë a) dalja nga skema e KOS Giro e kompanisë KESCO, e cila ishte pjesëmarrësi kryesor në skemë, dhe b) ndryshimi i mënyrës së kompensimit të qytetarëve për grumbullimin e kuponëve fiskalë nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës, e cila rimbursimin e qytetarëve për kuponë fiskalë e kryen përmes modulit të ACH-së për paga dhe pensione.

Tabela 2. Numri i transaksioneve ndërbankare në ACH (në mijëra)

Lloji i pagesave	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Numri i pagesave ACH	2,823.17	2,989.79	2,960.82	2,792.49	2,604.16
<i>Pagesa Normale</i>	264.50	335.97	360.09	452.45	308.20
<i>Pagesa Masive</i>	979.02	1,039.67	1,169.03	1,031.11	1,056.57
<i>Pagesa Kos Giro</i>	334.94	289.36	146.64	145.14	120.79
<i>Pagesa Paga/Pensione</i>	1,235.59	1,315.49	1,282.45	1,161.68	1,117.43
<i>Pagesa Debitim Direkt</i>	9.13	9.30	2.60	2.12	1.17

Burimi: BQK (2018)

Numri i pagesave normale gjatë këtij tremujori ishte rreth 308.2 mijë transaksione, që krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë paraqet rritje prej rreth 16.5%. Po ashtu edhe pagesat masive u karakterizuan me trend rritës 7.9%. Pagesat përmes moduleve tjera patën rënie: pagesat Kos Giro (63.9%), pagesat për paga dhe pensione (9.6%) ndërsa debitimi direkt (86.9%).

Pagesat e pagave dhe pensioneve si dhe pagesat masive vazhdojnë të përbëjnë numrin më të madh të transaksioneve të procesuara përmes ACH-së me 42.9% respektivisht 40.7%.

Në tabelën 3 është paraqitur vlera e transaksioneve ndërbankare nga TM1 i vitit 2017 deri në TM1 të vitit 2018. Vlera e përgjithshme e transaksioneve ndërbankare të procesuara përmes sistemit RTGS gjatë këtij tremujori arriti në 1.81 miliardë euro. Vlera e pagesave të klientëve përmes RTGS-së kaloi mbi 978.4 milionë euro që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017 që paraqet rritje prej 17.4%, ndërsa vlera e llojeve tjera të pagesave ishte më e vogël krahasuar me pagesat e klientëve përmes RTGS-së.

Tabela 3. Vlera e transaksioneve ndërbankare në RTGS (në milionë)

Lloji i pagesave	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Vlera e pagesave RTGS	1,717.72	1,927.29	1,893.83	1,986.02	1,810.39
<i>Pagesa të klientëve</i>	833.79	1,008.38	1,063.00	1,172.67	978.46
<i>Pagesa bankë-bankë</i>	689.85	594.85	730.94	640.65	628.45
<i>Letra me Vlerë</i>	194.07	324.06	99.90	172.70	203.48

Burimi: BQK (2018)

Njëjtë sikurse te numri i transaksioneve të procesuara përmes RTGS-së, ashtu edhe tek vlera e tyre, pagesat e klientëve kanë pjesëmarrjen më të madhe (54.1%), pastaj janë pagesat ndërmjet bankave (34.7%) dhe Letrat me Vlerë (11.2%).

Në tabelën 4 është paraqitur vlera e transaksioneve ndërbankare të procesuara përmes sistemit të ACH-së. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë shihet se vlera e përgjithshme e transaksioneve ndërbankare të procesuara përmes ACH-së në TM1 2018 u rrit për 5.7%. Pagesat e procesuara përmes modulit për pagesa normale u rritën për 12.8%, pagesat masive 8.8%, pagesat përmes modulit për paga dhe pensione 11.3%, ndërsa rënie patën pagesat Kos Giro (7.2%) dhe pagesat përmes Debitimit Direkt.


Tabela 4. Vlera e transaksioneve ndërbankare në ACH (në milionë)

Lloji i pagesave	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Vlera e pagesave ACH	880.13	1,022.55	1,077.90	1,126.12	930.56
<i>Pagesa Normale</i>	251.51	320.36	337.58	389.94	283.88
<i>Pagesa Masive</i>	158.90	165.48	180.78	176.32	173.03
<i>Pagesa Kos Giro</i>	244.86	300.50	332.05	304.93	227.31
<i>Pagesa Paga/Pensione</i>	221.38	233.25	227.44	254.88	246.30
<i>Pagesa Debitim Direkt</i>	3.49	2.96	0.05	0.05	0.04

Burimi: BQK (2018)

Në grafikun 1 janë prezantuar të dhëna lidhur me transferet e kreditit të iniciuara në formë letre, si dhe në formë elektronike (përmes internetit). Nga grafiku mund të konstatohet se rreth 34.1% e transfereve të kreditit janë iniciuar në formë letër, ndërsa 65.9% e transfereve të kreditit janë iniciuar në mënyrë elektronike (përmes internetit).

Grafiku 1: Transferet e kreditit




Burimi: BQK (2018)


Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën 2 dhe 3, mund të konstatohet lidhur me peshën e secilit lloj të pagesave në vlerën e përgjithshme të pagesave.

Në tremujorin e parë të vitit 2018, pagesat individuale të cilat procesohen përmes komponentit ACH përbëjnë 11.72% të numrit të përgjithshëm të pagesave ndërsa në vlerën e përgjithshme të transaksioneve ndërbankare ato marrin pjesë me 10.36%. Pagesat me vlerë të madhe dhe ato prioritare (të iniciuara nga klientët) të cilat procesohen përmes komponentit RTGS zënë vetëm 0.88% të numrit të transaksioneve, ndërsa vlera e tyre përbën rreth 35.70% të vlerës së transaksioneve.

Grafiku 2. Përqindja e transaksioneve (sipas numrit)



Grafiku 3. Përqindja e transaksioneve (sipas vlerës)




Burimi: BQK (2018)

Burimi: BQK (2018)

Pagesat masive përbëjnë rreth 40.19 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve ndërsa vlera e tyre merr pjesë me 6.31 përqind në vlerën e transaksioneve. Pagesat e procesuara përmes modulit të pagesave për paga dhe pensione përbëjnë rreth 42.51 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve ndërbankare ndërsa vlera e tyre rreth 8.99 përqind të vlerës së transaksioneve ndërbankare. Debitimi Direkt merr pjesë me më pak se 1 %, si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve ndërbankare.


Pagesat Kos Giro vazhdojnë të jenë pjesë e rëndësishme e sistemit të pagesave: numri i tyre përbën 4.59 % të numrit të transaksioneve, ndërsa vlera e tyre përbën 8.29 % të vlerës së transaksioneve ndërbankare. Letrat me vlerë marrin pjesë me numër shumë të vogël (rreth 0.05 %), por vlera e tyre përbën rreth 7.42 % të vlerës së përgjithshme të transaksioneve ndërbankare. Kategoria tjetër e pagesave, pagesat bankë-bankë përbëjnë 0.04 % të numrit të transaksioneve, ndërsa vlera e tyre përbën 22.93 % të vlerës së transaksioneve ndërbankare.

Grafiku 4. Numri i transaksioneve ndërbankare (në milionë)



Burimi: BQK (2018)

Grafiku 5. Vlera e transaksioneve ndërbankare (në miliardë euro)



Burimi: BQK (2018)

Në figurat 4 dhe 5 është paraqitur numri dhe vlera e përgjithshme e transaksioneve ndërbankare nga tremujori i parë i vitit 2017 deri në tremujorin e parë të vitit 2018.

2. Numri i llogarive bankare

Shtrirja gjeografike e bankave komerciale në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës ka ndikuar që qytetarët të kenë më të lehtë qasjen në banka dhe rrjedhimisht pjesa më e madhe e popullatës është e përfshirë në një mënyrë apo tjetër në marrëdhënie me banka (p.sh. kanë llogari bankare, kartela, kredi etj.).

Në tabelën 5 është paraqitur numri i llogarive bankare të ndara sipas mbajtësve të llogarive. Në TM1 të vitit 2018 numri i përgjithshëm i llogarive bankare është 2,114,691 nga të cilat 98.2% janë llogari të rezidentëve, ndërsa vetëm rreth 1.8% janë llogari të jorezidentëve. Në krahasim me tremujorin e kaluar (TM4 2017), numri i llogarive ka shënuar rritje rreth 7.5%. Nëse krahasimin e bëjmë me periudhën e njëjtë të një viti më parë (TM1 2017), do të vërejmë se numri i përgjithshëm i llogarive është ngritur për rreth 11.9%.

Tabela 5. Numri i llogarive bankare


Përshkrimi i Llogarive	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Llogaritë e klientëve	1,890,253	1,913,016	1,952,929	1,967,755	2,114,691
Llogari të rezidentëve	1,861,347	1,883,417	1,921,501	1,936,250	2,077,578
<i>individuale</i>	1,728,351	1,750,490	1,788,983	1,802,745	1,934,055
<i>afariste</i>	132,996	132,927	132,518	133,505	143,523
Llogari të jorezidentëve	28,906	29,599	31,428	31,505	37,113
<i>individuale</i>	28,041	28,720	30,598	30,711	36,612
<i>afariste</i>	865	879	830	794	501

Burimi: BQK (2018)

Numri kaq i lartë i llogarive bankare mund të shpjegohet me faktin se një klient mund të ketë llogari në më shumë se një bankë në të njëjtën kohë.

Në grafikun 6 janë paraqitur llogaritë e klientëve, sipas tipit të llogarisë. Nga të dhënat në grafik konstatohet se nga numri i përgjithshëm i llogarive të klientëve, 80.9% e tyre janë llogari rrjedhëse (1,710,162), 17.8% llogari të kursimeve (377,250) si dhe 1.3% llogari të depozitave (llogari të afatizuara).


Grafiku 6. Numri i llogarive të klientëve



Burimi: BQK (2018)

2.1. Llogaritë të cilave klientët mund t'iu qasen përmes internetit

Në grafikun 7 është paraqitur numri i llogarive të cilave klientët mund t'iu qasen përmes internetit. Në fund të TM1 të vitit 2018 numri i llogarive rrjedhëse të cilave klientët mund t'iu qasen përmes internetit arriti në 232,324 që krahasuar me tremujorin e njëjtë të një viti më parë paraqet rënie prej rreth 4.1%¹.

Grafiku 7. Numri i llogarive e-banking²

Burimi: BQK (2018)

Në tabelën 6 është paraqitur numri i llogarive të cilave klientët mund t'iu qasen përmes internetit sipas tipit të llogarive, të ndara në llogari të individëve dhe llogari afariste. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë shihet se nga numri i përgjithshëm i llogarive e-banking,

¹ Duke filluar nga data 1 Janar 2018 ka hyrë në fuqi rregullorja e re për Raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave. Sipas rregullores së re bankat duhet të raportojnë vetëm numrin e llogarive rrjedhëse të cilave klientët mund të j'u qasen përmes internetit, ndërsa deri më 31 dhjetor 2017 janë raportuar edhe llogaritë e kursimit dhe ato të afatizimit të cilave klientët mund tu qaseshin përmes internetit.

² Për periudhat TM1-TM4 të vitit 2017 janë bërë revidime të të dhënave për numrin e llogarive të cilave klientët mund t'iu qasen përmes internetit, si rezultat i disa përmirësimeve të bëra nga një bankë raportuese.

84.8% janë llogari që shfrytëzohen nga personat privatë, ndërsa vetëm 15.2% janë llogari që shfrytëzohen nga ana e bizneseve.


Tabela 6. Numri i llogarive e-banking sipas llojit

Përshkrimi	Numri	%
Llogari individuale	197,051	84.82%
<i>a - individuale (rezident)</i>	191,682	
<i>b - individuale (jo-rezident)</i>	5,369	
Llogari afariste	35,273	15.18%
<i>a - afariste (rezident)</i>	35,049	
<i>b - afariste (jo-rezident)</i>	224	
Gjithsej	232,324	100.00%

Burimi: BQK (2018)


Në grafikun 8 dhe 9 është paraqitur numri dhe vlera e pagesave të procesuara përmes shërbimit e-banking gjatë dy viteve të fundit, të ndara në periudha tremujore. Me ndryshimin e rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave, ka ndryshuar edhe metodologjia e raportimit të pagesave të realizuara përmes shërbimit e-banking. Deri në fund të vitit 2017 janë raportuar të gjitha pagesat e iniciuara përmes shërbimit e-banking (edhe ato mes llogarive të të njëjtit klient), ndërsa me rregulloren e re (në fuqi nga data 1 janar 2018), bankat raportojnë vetëm ato transaksione të iniciuara përmes internetit, kur iniciuesi (paguesi) dhe përfituesi (i paguari) janë dy subjekte të ndryshme, pra nuk raportohen lëvizjet e mjeteve nga një llogari në tjetrën të të njëjtit klient.

Grafiku 8. Numri i transaksioneve e-banking (në mijëra)



Burimi: BQK (2018)

Grafiku 9. Vlera e transaksioneve e-banking (në miliardë)



Burimi: BQK (2018)

3. Terminalet ATM dhe POS

Në tabelën 7 është paraqitur numri i terminaleve ATM nga tremujori i parë i vitit 2017 deri në tremujorin e parë të vitit 2018. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë mund të vërehet rënie e numrit të terminaleve ATM përgjatë periudhave.

Në fundin e TM1 të vitit 2018 numri i terminaleve ATM ishte 507 terminale. Të gjitha terminalet ATM që janë instaluar në Kosovë ofrojnë funksionin e tërheqjes, ndërsa 191 prej tyre ofrojnë edhe mundësinë e deponimit.


Tabela 7. Numri i Terminaleve ATM

Terminalet sipas funksionit	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Automated Teller Machines (ATM)	520	518	511	512	507
<i>prej të cilave:</i>					
1 - ATM me funksion tërheqje cash	520	518	511	512	507
3 - ATM me funksion depozitim cash	122	123	168	172	191

Burimi: BQK (2018)

Në grafikun 10 është paraqitur shpërndarja e rrjetit të terminaleve ATM në qytetet më të mëdha të Kosovës për TM1 të vitit 2018. Sipas grafikut të mëposhtëm, pjesa më e madhe e terminaleve ATM është e koncentruar në qytetin e Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë mes qyteteve tjera të Kosovës. Arsyet e përqendrimit kaq të madh të terminaleve ATM në Prishtinë janë të ndryshme si: numri i madh i banorëve që jetojnë në Prishtinë, numri i filialeve të bankave, bizneset që operojnë në këtë qytet, etj.

Grafiku 10. Shpërndarja e terminaleve ATM nëpër qytete



Burimi: BQK (2018)

Tabela në vijim paraqet numrin e terminaleve POS të instaluar në Kosovë. Terminalet POS u mundësojnë klientëve kryerjen e pagesave me kartela pa pasur nevojë për para të gatshme. Kjo është një mënyrë shumë e lehtë dhe e sigurt e kryerjes së pagesave për mallra

apo shërbime të ndryshme. Në TM1 2018 numri i terminaleve POS ishte 12,084 që krahasuar me tremujorin përkatës të vitit 2017 paraqet rritje prej rreth 14.9%.


Tabela 8. Numri i terminaleve POS

Terminalet sipas funksionit	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Terminale POS (Point of Sale)	10,518	10,631	10,778	11,501	12,084
<i>prej të cilave:</i>					
1 - POS me funksion tërheqje cash	168	168	168	165	165
2 - terminale EFTPOS	10,341	10,463	10,610	11,336	11,919

Burimi: BQK (2018)

Në grafikun 11 është paraqitur shpërndarja e rrjetit të terminaleve POS në qytetet më të mëdha të Kosovës për TM1 të vitit 2018. Ngjashëm me shpërndarjen e terminaleve ATM edhe rrjeti i terminaleve POS është më i përqendruar në Prishtinë.

Grafiku 11. Shpërndarja e terminaleve POS nëpër qytete



Burimi BQK (2018)

4. Numri i kartelave

Në tabelën 9 është paraqitur numri i kartelave sipas funksionit që kryejnë, nga tremujori i parë i vitit 2017 deri në tremujorin e parë të vitit 2018.

Në TM1 2018, numri i kartelave me funksion debiti shënoi rritje prej rreth 5.1% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, po ashtu edhe numri i kartelave të kreditit pati trend rritës prej rreth 4.5%. Numri i përgjithshëm i kartelave në TM1 2018 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar pati rritje prej rreth 5.3%.


Tabela 9. Numri i kartelave sipas funksionit (në mijë)

Kartelat sipas funksionit	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Kartela me funksion cash-i	1,052.5	1,014.0	1,046.3	1,090.9	1,108.3
Kartela me funksion pagese	1,052.5	1,014.0	1,046.3	1,090.9	1,108.3
<i>prej të cilave:</i>					
1 - Kartela me funksion debiti	893.8	856.7	886.0	926.2	939.6
2 - Kartela me funksion krediti	158.7	157.3	160.3	164.7	165.8
3 - Kartela me funksion debitimi të vonuar	-	-	-	-	2.4
Kartela me funksion para elektronike	0.26	0.29	0.33	0.40	0.46
Numri total i kartelave	1,042.5	1,014.3	1,046.6	1,091.4	1,108.7

Burimi BQK (2018)

Në grafikun 12 është paraqitur numri i kartelave të debitit, kreditit si dhe kartelave me funksion debiti të vonuar sipas periudhave. Kartelat e debitit vazhdojnë edhe më tutje të mbeten në numër më të madh krahasuar me llojet e tjera të kartelave. Kështu në TM1 2018 kartelat e debitit përbënin rreth 85% të numrit të përgjithshëm të kartelave, kartelat e kreditit merrnin pjesë me rreth 15% të numrit të përgjithshëm të kartelave.


Grafiku 12. Numri i kartelave sipas funksionit



Burimi: BQK (2018)


Në figurat 13 dhe 14 është paraqitur numri i kartelave të debitit dhe kreditit, si dhe numri i përgjithshëm i tyre sipas periudhave. Kartelat e debitit vazhdojnë edhe më tutje të mbeten në numër më të madh krahasuar me llojet e tjera të kartelave.

Grafiku 13. Debit dhe kredit kartelat (në mijëra)



Burimi: BQK (2018)


Grafiku 14. Numri i përgjithshëm i kartelave (në mijëra)



Burimi: BQK (2018)

Në grafikun 15 është paraqitur shpërndarja e kartelave sipas moshës së poseduesve të tyre. Nga të dhënat e paraqitura në grafik shihet se nga numri i përgjithshëm i poseduesve të kartelave, 12.16% e tyre janë të moshës 18-25 vjeç, 22.95% janë të moshës 26-35 vjeç, 21.49% të moshës 36-45 vjeç, 18.08% të moshës 46-55 vjeç dhe 25.32% të moshës mbi 55 vjeç.


Grafiku 15. Poseduesit e kartelave sipas moshës



Burimi: BQK (2018)

Në grafikun 16 është paraqitur struktura e mbajtësve të kartelave sipas gjinisë. Nga të dhënat e paraqitura në grafik, mund të konstatohet për shpërndarje joproporcionale të kartelave sipas gjinisë së poseduesve të tyre, me ç'rast, nga numri i përgjithshëm i kartelave, vetëm 32.84% e tyre zotërohen nga femrat, ndërsa pjesa tjetër prej 67.16% zotërohet nga meshkujt.

Grafiku 16. Poseduesit e kartelave sipas gjinisë



Burimi: BQK (2018)

5. Transaksionet me Kartela

Nga tabela numër 10 mund të shihet lëvizja e numrit të transaksioneve me kartela duke filluar nga TM1 2017 deri në tremujorin e parë të vitit 2018 sipas periudhave të rregullta tremujore. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, mund të konstatohet se numri i përgjithshëm i transaksioneve me kartela ka pasur rritje të vazhdueshme përgjatë çdo periudhe.

Në TM1 të vitit 2018 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 25.1% krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë (TM1 2017). Numri i tërheqjeve në терминаlet ATM u rrit për 12.2%, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 38.9%.

Tabela 10. Numri i transaksioneve me kartela (në mijë)

Përshkrimi	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Numri i Transaksioneve	5,191.70	5,754.11	5,714.54	6,049.09	6,498.50
<i>prej të cilëve:</i>					
1 - ATM tërheqje cash	3,198.83	3,528.17	3,467.19	3,598.50	3,589.17
2 - ATM depozitime	238.58	299.55	326.64	398.71	403.50
3 - Kredit transferet nëpërmjet ATM	6.86	7.19	6.54	9.32	8.77
4 - Tërheqje cash në terminale POS	0.70	0.90	3.58	7.21	70.07
5 - Pagesa me kartela në POS	1,746.73	1,918.31	1,910.59	2,035.36	2,426.99

Burimi: BQK (2018)

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 10, shihet se tërheqjet në ATM përbëjnë pjesën më të madhe të transaksioneve me kartela. Në TM1 2018, tërheqjet në ATM përbënin rreth 55.2% të numrit të përgjithshëm të transaksioneve me kartela, pagesat në POS terminale rreth 37.3%, kredit transferet në ATM rreth 0.1%, tërheqje në POS terminale 1.08% dhe deponimet cash në ATM rreth 6.2% të numrit të përgjithshëm të transaksioneve me kartela.

Në tabelën 11 është paraqitur vlera e transaksioneve me kartela gjatë vitit 2017 dhe vitit 2018 e ndarë sipas periudhave tremujore të raportimit. Nga të dhënat në tabelë, shihet se

krahas rritjes së numrit të transaksioneve me kartela është rritur edhe vlera e përgjithshme e këtyre transaksioneve.

Tabela 11. Vlera e transaksioneve me kartela (në milionë)


Përshkrimi	2017				2018
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Vlera e transaksioneve	627.93	766.36	863.48	819.02	836.53
<i>prej të cilave:</i>					
1 - ATM tërheqje cash	403.32	482.68	527.55	492.14	497.90
2 - ATM depozitime	168.84	217.82	262.76	253.61	250.46
3 - Kredit Transfere nëpërmjet ATM	0.11	0.14	0.15	0.53	0.62
4 - Tërheqje cash në terminale POS	0.64	1.03	3.50	1.25	1.73
5 - Pagesa me kartela në terminale POS	55.02	64.70	69.51	71.48	85.82

Burimi: BQK (2018)

Krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë, në TM1 2018 shihet se vlera e përgjithshme e transaksioneve me kartela është rritur për rreth 33.2%, vlera e tërheqjeve në ATM është ngritur për rreth 23.5%, vlera e pagesave në POS terminale është ngritur për 56%, ndërsa depozitimi i parave përmes ATM terminaleve ka pasur ngritje prej 48.35% dhe ka arritur vlerën e mbi 250.46 milionë euro.

Nga të dhënat në tabelën 11 shihet se tërheqjet në ATM përbëjnë rreth 59.5% të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela, pagesat në POS terminale përbëjnë rreth 10.2%, deponimet në ATM rreth 30%, ndërsa kredit transferet përmes ATM-ve dhe tërheqjet në POS terminale përbëjnë rreth 0.08% të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela.

Grafiku 17. Pjesëmarrja e transaksioneve me kartela sipas numrit dhe sipas vlerës




Burimi: BQK (2018)

Grafiku 18 paraqet numrin dhe vlerën e pagesave të realizuara në tremujorin e parë të vitit 2018, të ndara sipas llojit të kartelave; pagesat me kartela me funksion debiti, krediti si dhe debiti të vonuar.

Grafiku 18. Numri dhe vlera e pagesave me kartelë

Numri (djathtas) dhe vlera (majtas) e pagesave me kartela, sipas llojit të kartelave



Burimi: BQK (2018)

Sipas të dhënave të paraqitura ne grafikun 18, pagesat me kartelë që kanë funksion debiti përbëjnë 72.4% të numrit të përgjithshëm të pagesave, ato me funksion krediti përbëjnë 26.3% kurse vetëm 1.2% janë pagesa me kartela me funksion debiti të vonuar.

Edhe vlera e tyre dominohet nga kartelat me funksion debiti, të cilat përbëjnë 66.5% të vlerës së përgjithshme të pagesave të realizuara me kartelë.